



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUTI I STATISTIKAVE

DREJTORIA E INTEGRIMIT EVROPIAN DHE KOORDINIMIT TË PROJEKTEVE  
Sektori i Monitorimit të zbatimit të PSZ-së

# Raporti 4-mujor i monitorimit të Programit të Statistikave Zyrtare<sup>1</sup> (Shtator – Dhjetor 2018)

INSTAT - Instituti i Statistikave

---

Tel+(355) 4 2222411  
+(355) 4 2233356  
Fax+(355) 4 2228300

Rr. Vllazën Huta, Nd. 35, H. 1, Nj.A. Nr.2, 1017,  
Tiranë, Shqipëri

[info@instat.gov.al](mailto:info@instat.gov.al)

---

<sup>1</sup> Ky raport hartohet në zbatim të Nenit 17, pika 5 të Ligjit nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare” Në mbështetje në nenit 17, pika 5 e Ligjit nr. 17/2018 “Për statistikat zyrtare”, Drejtori i Përgjithshëm i INSTAT ka përgjegjësinë për t’i paraqitur Këshillit të Statistikave raporte të shkurtra 4-mujore për ecurinë e zbatimit të Programit të Statistikave Zyrtare.

## Tabela e Përmbajtjes

Hyrje .....	3
PROGRES-RAPORTI SHTATOR – DHJETOR 2018 .....	4
Fusha prioritare 02: Drejtimi Ekonomik .....	4
Aktivitete statistikore të realizuara.....	4
Rezultatet e pritshme .....	4
Aktivitete statistikore të porealizuara .....	4
Fusha prioritare 04: Performancat Ekonomike dhe Sociale .....	4
Aktivitete statistikore të realizuara.....	5
Rezultatet e pritshme .....	6
Aktivitete statistikore të porealizuara .....	7
Fusha prioritare 06: Statistikat e Ndërmarrjeve Ekonomike .....	7
Aktivitete statistikore të realizuara.....	7
Rezultatet e pritshme .....	8
Aktivitete statistikore të porealizuara .....	9
Fusha prioritare 07: Njerëzit e Evropës.....	9
Aktivitetet statistikore të realizuara .....	9
Rezultatet e pritshme .....	10
Fusha prioritare 08: Statistikat Sektoriale, Bujqësore dhe Mjedisore e Gjeohapësinore .....	10
Aktivitete statistikore të realizuara.....	11
Rezultatet e pritshme .....	11
Aktivitete statistikore të porealizuara .....	13
Fusha prioritare 11: Statistikat Shumëqëllimore dhe Efienca e Fituar në Prodhim .....	13
Aktivitete statistikore të realizuara.....	13
Rezultatet e pritshme .....	13
Aktivitete statistikore të porealizuara .....	14

## Hyrje

Programi i Statistikave Zyrtare është dokumenti bazë që parashikon prodhimin e statistikave zyrtare nga Sistemi Kombëtar Statistikor të nevojshme për vëzhgimin e gjendjes ekonomike, shoqërore dhe mjedisore në Republikën e Shqipërisë. Monitorimi i ecurisë së programit është element shumë i rëndësishëm për garantimin e plotësimin të aktiviteteve statistikore të parashikuara në të.

Ligji nr. 17/2018 “Për Statistikat Zyrtare” parashikon si një ndër instrumentet monitorues raportimin periodik me bazë 4-mujore.

Raporti 4-mujor mbi zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare për periudhën Shtator – Dhjetor, 2018 është përgatitur në bashkëpunim me agjencitë e tjera statistikore të cilat kanë dhënë informacion për modulet statistikore nën përgjegjësinë e tyre sipas programit. Ky raport përmban në strukturën e tij një informacion të shkurtër të ecurisë së secilës fushe prioritare statistikore, aktivitetet statistikore që janë realizuar dhe rezultatet e arritura gjatë periudhës së raportimit. Në fund të çdo fushe prioritare statistikore, raportohen edhe aktivitetet statistikore të cilat nuk janë realizuar sipas pritshmërive të parashikuara në program, si dhe shkaqet e këtyre mosrealizimeve.

## **PROGRES-RAPORTI SHTATOR – DHJETOR 2018**

### **Fusha prioritare 02: Drejtimi Ekonomik**

Kjo fushë prioritare mbulon prodhimin e statistikave financiare të qeverisë, administratës publike dhe statistikave mbi defiçitin dhe borxhin publik.

- Objektivi i kësaj fushe është përpilimi i statistikave financiare të qeverisë sipas manualit të FMN-së të vitit 2014 dhe ESA 2010 në baza 3-mujore dhe vjetore, prodhimi i statistikave të llogarive jo-financiare të administratës publike si dhe përdorimi i një programi të unifikuar i të dhënave të borxhit publik.

Agjencitë statistikore përgjegjëse: INSTAT, Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

#### **Aktivitetet statistikore të realizuara**

1. Statistikat Financiare të qeverisë sipas GFSM2014
2. Pasqyrat Financiare të Konsoliduara të Qeverisë
3. Statistikat e Borxhit

#### **Rezultatet e pritshme**

1. Publikimi i të dhënave të borxhit të jashtëm dhe të brendshëm të sektorit buxhetor të qeverisë.
2. Raportimi i pasqyrave financiare të konsoliduara të qeverisë.
3. Raportimi i statistikave financiare të qeverisë sipas GFSM 2014 tek FMN-ja.

#### **Aktivitetet statistikore të porealizuara**

Për këtë fushë prioritare nuk ka aktivitetet statistikore të porealizuara.

### **Fusha prioritare 04: Performancat Ekonomike dhe Sociale**

Kjo fushë prioritare mbulon prodhimin e statistikave cilësore të llogarive vjetore sipas sektorëve, të metodologjisë dhe prodhimit të të dhënave të llogarive financiare, treguesve monetarë, financiarë dhe të llogarive kombëtare vjetore dhe tremujore me metodën e prodhimit. Gjithashtu në këtë fushë përfshihet dhe prodhimi i statistikave të bilancit të pagesave, indeksit të çmimeve të konsumit (IÇK) si dhe indeksit të harmonizuar të çmimeve të konsumit (IHÇK) në përputhje të plotë me metodologjinë e Eurostatit.

- Objektivi i kësaj fushe është zbatimi i plotë i metodologjisë së ESA 2010 në prodhimin e statistikave të llogarive kombëtare si dhe zhvillimi i metodologjisë dhe hartimi i statistikave të normave të interesit sipas kërkesave të Bankës Qëndrore Evropiane.

Agjencitë statistikore përgjegjëse: INSTAT, Banka e Shqipërisë.

## Aktivite statistikore të realizuara

1. Llogaritë Kombëtare Vjetore, Produkti i Brendshëm Bruto (PPB) me metodën e prodhimit
2. Llogaritë vjetore, PBB metoda e Shpenzimeve
3. Llogaritë Rajonale
4. PBB tremujore me metodën e prodhimit, e përshtatur dhe e papërshtatur sezonalisht
5. Llogaritë financiare të sektorit financiar
6. Llogaritë financiare të sektorit "Pjesa tjetër e botës" (jorezidentët)
7. Llogaritë financiare të sektorit të qeverisë së përgjithshme
8. Llogaritë financiare të sektorëve të korporatave jo-financiare dhe ekonomive familjare
9. Llogaritë financiare të gjithë sektorëve të ekonomisë
10. Agregatët monetarë
11. Të dhëna të bankës qendrore - Bilanci sektorial
12. Të dhëna të bankës qendrore - Paraqitja monetare
13. Të dhëna të bankave paradepozituese - Bilanci sektorial
14. Të dhëna të bankave paradepozituese - Paraqitja monetare
15. Bilanci sektorial i shoqërive të kursim - kreditit
16. Të dhëna të korporatave të tjera depozituese - bilanci sektorial
17. Të dhëna të korporatave të tjera depozituese - paraqitja monetare
18. Paraqitja monetare e korporatave depozituese
19. Bilanci sektorial i institucioneve të tjera financiare
20. Paraqitja monetare e institucioneve të tjera financiare
21. Depozitat e përfshira në paranë e gjerë
22. Depozitate e reja sipas monedhës
23. Depozitat me afat në Lek, Usd dhe Euro, sipas subjektit dhe maturitetit
24. Depozitat sipas qarkut
25. Kredia për ekonominë
26. Huatë e reja sipas monedhës
27. Huatë sipas qëllimit të përdorimit dhe monedhës (fluks dhe stok) dhe sipas aktivitetit ekonomik
28. Huatë sipas qarkut, afatit, subjektit dhe aktivitetit ekonomik
29. Normat e interesit për depozitat dhe huatë e reja / dhe gjendje në fund të periudhës

30. Kursi i këmbimit
31. Bilanci tremujor i Pagesave
32. Pozicioni i Investimeve Ndërkombëtare
33. Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK)
34. Indeksi i Harmonizuar i Çmimeve të Konsumit (IHÇK)
35. Matja e Fuqisë Blerëse (MFB)

## Rezultatet e pritshme

1. Hartimi i plotë dhe publikimi i llogarive financiare për të gjithë sektorët e ekonomisë, gjendje dhe flukse, në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare.
2. Klasifikimi i njësive institucionale në sektorë institucionale, duke u grupuar në:
  - a. Njësiti jo-financiare
  - b. Njësiti Financiare
  - c. Qeveria
  - d. Familjet
  - e. Institucionet jo-fitimprurëse në shërbim të familjeve
3. Tregues përkatës të Llogarisë së Prodhimit të vlerësuar sipas sektorëve Institucionale: Prodhimi (tregtar, për përdorim vetjak, prodhim jo-tregtar), Konsumi Ndërmjetës, Taksat mbi produktet, Subvencionet mbi produktet dhe Vlera e Shtuar.
4. Vlerësime të bëra me çmime korrente.
5. Tabela të përpiluara burime, përdorime, me çmime korrente dhe konstante me frekuencë vjetore me nivel detajimi 88 aktivitete (Nace Rev. 2) x 88 produkte (CPA 2008).
6. Tabela të përpiluara input-output me çmime bazë e ndarë për prodhimin e brendshëm, importet dhe totale me frekuencë çdo 5 vjet me nivel detajimi 88 aktivitete (Nace Rev. 2) x 88 produkte (CPA 2008).
7. Tabela të përpiluara të përdorimeve me çmime bazë e ndarë për prodhimin e brendshëm, importet dhe totale me frekuencë çdo 5 vjet me nivel detajimi 88 aktivitete (Nace Rev. 2) x 88 produkte (CPA 2008).
8. Tabela burime, përdorime dhe input-output të publikuara në nivel 35 grup-aktivitete (Nace Rev. 2) x 35 grup-produkte (CPA 2008).
9. Përbushja e kërkesave të sistemit të transmetimit ESA 2010 (ESA 2010 Transmission programme of data).
10. Indeksi mujor i Çmimeve të Konsumit sipas hierarkisë së mëposhtme:
  - a. Indeksi Total
  - b. Indeksi sipas grupeve kryesore
  - c. Indeksi sipas grup-mallrave
  - d. Indeksi në nivel të detajuar sipas artikujve
11. Ndryshimi vjetor dhe mesatar vjetor i Çmimeve të Konsumit.
12. Ndryshimi mujor i Çmimeve të Konsumit.
13. Lista e përditësuar e njësive tregtare në periudha vjetore.
14. Shporta e përditësuar e produkteve me përshkrimet përkatëse në periudha vjetore.
15. Peshat e përditësuara të produkteve në periudha vjetore.

16. Shporta e produkteve për pensionistët.
17. Indeksi mujor i Çmimeve të Harmonizuara të Konsumit sipas hierarkisë së mëposhtme:
  - a. Indeksi Total
  - b. Indeksi sipas grupeve kryesore
  - c. Indeksi sipas grup-mallrave
  - d. Indeksi në nivel 5-shifror
18. Indeksi Mujor i Çmimeve të Harmonizuara të Konsumit.
19. Ndryshimi mujor i Çmimeve të Harmonizuara të Konsumit.
20. Ndryshimi vjetor dhe mesatar vjetor i Çmimeve të Harmonizuara të Konsumit.
21. Lista e përditësuar e njërive tregtare në periudha vjetore.
22. Shporta e përditësuar e produkteve me përshkrimet përkatëse në periudha vjetore.
23. Peshat e përditësuara të produkteve në periudha vjetore.
24. Prodhimi i Brendshëm Bruto, (PBB) për frymë në Fuqi Blerëse (PPPs).
25. Konsumi për frymë.
26. Indeksi i nivelit të çmimeve.
27. Inventari i burimeve të informacionit.
28. Burimi kryesor i përcaktuar.

## Aktivitete statistikore të perealizuara

Për këtë fushë prioritare nuk ka aktivitete statistikore të perealizuara.

## Fusha prioritare 06: Statistikat e Ndërmarrjeve Ekonomike

Kjo fushë prioritare mbulon prodhimin e statistikave strukturore dhe afatshkurtra të ndërmarrjeve, statistikave FATS, të produkteve të industrisë përpunuese, turizmit, tregtisë së jashtme të mallrave dhe shërbimeve si dhe prodhimin e statistikave mbi kërkim zhvillimin dhe inovacionin.

- Objektivi i kësaj fushe prioritare është përmirësimi i cilësisë së të dhënave strukturore të ndërmarrjeve si dhe prodhimi i treguesve cilësorë në kuadër të prodhimit të të dhënave afatshkurtra mbi to; prodhimi i të dhënave cilësore mbi mallrat e industrisë përpunuese, FATS, turizmin si dhe prodhimi i të dhënave mbi kërkim zhvillimin dhe inovacionin në përputhje me standartet ndërkombëtare.

Agjencitë statistikore përgjegjëse: INSTAT, Banka e Shqipërisë.

## Aktivitete statistikore të realizuara

1. Statistikat Strukturore të Ndërmarrjeve (SSN)
2. Produkte të Industrisë Përpunuese
3. Statistikat tremujore të ndërmarrjeve

4. Çmimet në industri dhe ndërtim
5. Lejet e ndërtimit të miratuara
6. Statistikat e Turizmit - Njësitë Akomoduese
7. Investimet e huaja direkte
8. Tregtia ndërkombëtare e shërbimeve
9. Tregtia e Jashtme e Mallrave

## Rezultatet e pritshme

1. Të dhëna bazë (të ardhurat dhe shpenzimet, investimet) sipas aktivitetit ekonomik, madhësisë së ndërmarrjeve dhe pronësisë.
2. Tregues kryesorë makro - ekonomikë të llogaritur, sipas aktivitetit ekonomik, madhësisë së ndërmarrjeve.
3. Të dhëna specifike për aktivitetet kryesore: Ndërtim, Transport, Tregti, Hotele dhe restorante.
4. Listë e mallrave të industrisë përpunuese.
5. Tregues në volum dhe vlerë mbi mallrat e industrisë përpunuese.
6. Indeksi i shitjeve neto në vlerë dhe në volum (si rezultat i deflatimit me indeksin e çmimeve) për aktivitetet e mbuluara në vrojtimin tremujor.
7. Indeksi i prodhimit në vlerë dhe në volum (si rezultat i deflatimit me indeksin e çmimeve) në Industri dhe Ndërtim.
8. Indeksi i punësimit.
9. Indeksi i pagave.
10. Indekset e Çmimeve të Prodhimit, Eksportit, Importit dhe Shërbimeve sipas aktiviteteve ekonomike.
11. Indekset e Kushtimit në Ndërtim.
12. Deflatorët përkatës për çdo aktivitet të mbuluar në anketë.
13. Tregues për lejet e ndërtimit në numër, sipërfaqe, vlerë e parashikuar sipas llojeve të ndërtimit, në nivel bashkie, qarku dhe vendi.
14. Tregues për lejet e ndërtimit sipas llojit dhe klientit.
15. Tregues për hyrje-daljet e shtetasve të huaj dhe shqiptarë sipas mënyrës së udhëtimit (ajër, det, tokë).
16. Tregues për hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit të udhëtimit dhe sipas shteteve/rajoneve.
17. Përgatitja e botimit "Turizmi në shifra".
18. Tregues për kapacitetin dhe frekuentimin e hoteleve dhe strukturave të ngjashme sipas klientëve.
19. Statistika të tregtisë së jashtme në periudha mujore, tremujore, vjetore sipas grup-mallrave.
20. Statistika të tregtisë së jashtme të mallrave, importet dhe eksportet sipas grup-mallrave.
21. Statistika mbi tregtinë e jashtme të mallrave, importet dhe eksportet sipas shteteve.
22. Statistika mbi tregtinë e jashtme të mallrave, importet dhe eksportet sipas karakteristikave të ndërmarrjeve.
23. Statistika të tregtisë së jashtme të mallrave, importet dhe eksportet sipas mënyrave të transportit.



24. Mbledhja e treguesve statistikore mbi kërkim-zhvillimin në Shqipëri.

## Aktivitete statistikore të perealizuara

Për këtë fushë prioritare nuk ka aktivitete statistikore të perealizuara.

## Fusha prioritare 07: Njerëzit e Evropës

Kjo fushë prioritare mbulon prodhimin e të dhënave mbi: demografinë, migracionin, censusin, punësimin dhe papunësinë, kostot dhe të ardhurat nga puna, gjininë dhe diskriminin, të ardhurat dhe nivelin e jetesës, arsimin, trajnimin profesional dhe të mësuarin gjatë gjithë jetës, kulturën dhe rininë, mbrojtjen sociale dhe shëndetin publik.

- Objektivi i kësaj fushe prioritare është prodhimi i statistikave demografike cilësore në nivel kombëtar dhe rajonal, përmirësimi i burimit të të dhënave mbi migracionin, fëmijët dhe moshimin si dhe realizimi në përputhje të plotë me standartet e Eurostat i censusit të popullsisë dhe banesave 2021 dhe vrojttimeve statistikore: ABF (Anketa e Buxhetit të Familjes), AKP (Anketa e Kostove të Punës), APK (Anketa e Përdorimit të Kohës), EU-SILC (Anketa mbi të Ardhurat dhe Nivelin e Jetesës) dhe AES (Anketa e Edukimit të të Rriturve).

Angjencitë statistikore përgjegjëse: INSTAT.

## Aktivitetet statistikore të realizuara

1. Lindjet e gjalla
2. Vdekjet mbi një vjeç
3. Vdekjet foshnjore
4. Popullsia ekonomisht aktive (Forca e punës)
5. Punësimi
6. Papunësia sipas Anketës së Forcave të Punës
7. Papunësia e regjistruar
8. Të dhëna administrative mbi pagat
9. Arsimi parashkollor
10. Arsimi 9 - vjecar
11. Arsimi i mesëm
12. Krimet dhe zbulimi i tyre
13. Autorët e veprave penale
14. Të dhëna administrative mbi statistikën e kulturës
15. Treguesit kryesorë statistikore “Anketa e Buxhetit të Familjes”
10. Treguesit e TUS
11. Treguesit kryesorë statistikore “Anketa e të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës”

## Rezultatet e pritshme

1. Statistika të plota mbi eventet demografike: lindje, vdekje.
2. Fillimi i punës përgatitore për Censin e ardhshëm.
3. Statistika mbi tregues të arsimit në të gjitha nivelet.
4. Statistika mbi personat në konflikt me ligjin.
5. Koeficientë lidhur me personelin e sistemit të Drejtësisë (oficer policie, prokuror, gjyqtarë dhe magjistratë).
6. Prodhimi i treguesve të kulturës bazuar në të dhënat administrative që vijnë nga Ministria e Kulturës dhe institucionet e varësisë.
7. Analiza longitudinale dhe cross-section i të dhënave të anketës SILC.
8. Ndërtimi i një strukture bazë sipas Eurostat për mbulimin e të gjithë hapave të anketës.
9. Kampioni i përditësuar, tregues të matur të saktësisë.
10. Gamë e përditësuar e indikatorëve nëpërmjet rishikimit të pyetësorit dhe manualit.
11. Sigurimi i prodhimit të indikatorëve bazë dhe vënia në shërbim të përdoruesve.
12. Ruajtja e krahasueshmërisë me vendet e BE dhe përditësimi me ndryshimet e metodologjisë së Eurostat.
13. Llogaritja e shpenzimeve të NjEF në nivel vendi dhe sipas qarqeve.
14. Struktura e shpenzimeve familjare për 12 grupet kryesore.
15. Struktura e shpenzimeve familjare sipas tipologjisë së familjeve.
16. Mënyra e ngrohjes në banesë.

## Aktivitete statistikore të perealizuara

Për këtë fushë prioritare nuk ka aktivitete statistikore të perealizuara.

## Fusha prioritare 08: Statistikat Sektoriale, Bujqësore dhe Mjedisore e Gjeohapësinore

Kjo fushë prioritare mbulon prodhimin e të dhënave mbi: ndërmarrjet dhe turizmin në nivel rajonal, infrastrukturën kombëtare të informacionit gjeo-hapsinor, mbetjet dhe substancat e rrezikshme, ujërat, pylltarinë dhe bio-diversitetin, energjinë, transportin, bujqësinë, prodhimet organike, përdorimin e tokës, blegtorinë, peshkimin, agromjedisin.

- Objektivi i kësaj fushe prioritare është hartimi dhe publikimi i harmonizuar dhe me cilësi i statistikave të ndërmarrjeve dhe turizmit në nivel rajonal, prodhimi në kohë dhe cilësi i të dhënave mbi mbetjet, ujërat, kullotat, biodiversitetin, transportin produktet bimore, peshkimin, madhësinë e tokës bujqësore në përdorim si dhe përgatitja e legjislacionit mbi pesticidet, të gjitha në harmoni me kërkesat dhe standartet e BE-së.

Agjencitë statistikore përgjegjëse: INSTAT.

## Aktivitetet statistikore të realizuara

1. Statistikat rajonale të ndërmarrjeve
2. Statistikat mbi cilësinë e ajrit, zhurmat, ujën, menaxhimin e mbetjeve
3. Përditësimi i vazhdueshëm i Njësive Statistikore (zonave të censusit - ZC)
4. Hartimi dhe miratimi i standardeve të layers "Njësiti Statistikore" në bashkëpunim me ASIG (sipas planifikimit 5 vjeçar të ASIG-ut).
5. Statistikat e mbetjeve dhe substancave të rrezikshme
6. Statistikat mbi ujërat
7. Statistikat e energjisë – Prodhimi
8. Transporti rrugor i mallrave
9. Statistikat e transportit - Hekurudhor
10. Statistikat e transportit - Detar
11. Statistikat e transportit - Ajror
12. Statistikat e transportit – Rajonale
13. Statistikat e aksidenteve

## Rezultatet e pritshme

1. Regjistri i Ndërmarrjeve dhe Regjistri i Njësive Lokale, i përditësuar.
2. Lista e fushave (ndryshoreve) mbi bazën e të cilave do të llogariten treguesit rajonalë të ndërmarrjeve.
3. Prodhimi i statistikave vjetore mbi mbetjet.
4. Statistika mbi landfill-et dhe zonat me rrezikshmëri të lartë (numri i tyre në nivel bashkie).
5. Riciklimi i mbetjeve dhe pikat e riciklimit.
6. Të dhëna mbi mbetjet e rrezikshme dhe menaxhimi i tyre në shkallë vendi.
7. Riciklimi i mbetjeve dhe pikat e riciklimit.
8. Të dhëna mbi mbetjet e rrezikshme dhe menaxhimi i tyre në shkallë vendi.
9. Prodhimi i treguesve të kërkuar vjetorë mbi ujërat në total në shkallë vendi.
10. Statistika mbi tregues të veçantë mbi ujën për furnizimin e popullatës, ujërat e ndotura dhe menaxhimi i tyre.
11. Statistika mbi bilancin e përgjithshëm dhe i detajuar mbi sasinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore që hyn dhe del nga Shqipëria sipas baseneve ujëmbledhës.
12. Statistika mbi reshjet vjetore, avullimin dhe transpirimin e ujit në total për vitin raportues, në shkallë vendi.
13. Përmirësimi i vazhdueshëm metodologjik, mbështetur në manualët dhe rregulloret që Eurostat përditëson për këtë fushë statistikore.
14. Statistika mbi bilancin total të ujërave mbi dhe nëntokësore në Shqipëri.
15. Statistika mbi basenet e lumenjve kryesorë të Shqipërisë River Basen Data (RBD).
16. Prodhimi i Bilancit të energjisë elektrike në publikimin specifik me periodicitet tremujor "Bilanci i energjisë elektrike".
17. Treguesit në volum mbi infrastrukturën e rrjetit.

18. Statistikat e transportit sipas llojeve të transportit.
19. Inventari i mjeteve.
20. Aksidentet.
21. Regjistër statistikor i mjeteve.
22. Tregues statistikorë mbi transportin hekurudhor të mallrave në njësi fizike dhe ton/km.
23. Tregues statistikorë mbi transportin hekurudhor të pasagjerëve në numër dhe pasagjerë/km.
24. Tregues statistikor mbi transportin hekurudhor ndërkombëtar të mallrave në njësi fizike dhe për ton/km.
25. Tregues statistikorë mbi aksidentet dhe numrin e personave të aksidentuar në transportin hekurudhor.
26. Tregues statistikorë mbi transportin detar të mallrave në njësi fizike.
27. Tregues statistikorë mbi transportin detar të pasagjerëve në numër.
28. Tregues statistikorë mbi numrin e anijeve të hyra dhe të dala nga portet shqiptare.
29. Tregues statistikorë mbi volumin e mallrave të hyra dhe të dala sipas llojit të mallit.
30. Numri i kompanive ajrore.
31. Numri i fluturimeve ajrore.
32. Numri i mbikalimeve.
33. Tregues statistikorë mbi transportin ajror të pasagjerëve në numër.
34. Tregues statistikorë mbi transportin ajror të mallrave / postës në njësi fizike.
35. Numri i mjeteve rrugore sipas rajoneve, për mallra dhe pasagjerë.
36. Numri i aksidenteve dhe numri i personave të aksidentuar sipas rajoneve.
37. Numri i aksidenteve dhe numri i personave të aksidentuar.
38. Struktura e shpendëve.
39. Numri i kafshë të therura gjatë vitit në thertore sipas llojeve: gjedhë, të leshta dhe të dhirta, derra dhe kategoritë statistikore të therjeve, pesha e gjallë totale dhe pesha e therur totale sipas llojeve të kafshëve.
40. Numri i kafshëve të therura gjatë vitit në fermë, sipas llojeve: gjedhë, të leshta dhe të dhirta, derra, shpendë dhe kategoritë statistikore të therjeve, pesha e gjallë totale dhe pesha e therur totale sipas llojeve të kafshëve.
41. Prodhimi mujor i vezëve për treg.
42. Sasia e qumështit të lopës sipas përmbajtjes së yndyrës dhe proteinave që shesin fermerët direkt në fabrikat përpunuese të qumështit gjatë muajit.
43. Sasia e qumështit të lopës, deles dhe dhive që shesin fermerët direkt në fabrikat përpunuese të qumështit gjatë vitit.
44. Sasia e produkteve të qumështit sipas llojeve (djathë, gjalpë, kos, gjizë) që prodhohet nga fabrikat dhe baxhot.
45. Sasia e qumështit të prodhuar në fermë sipas llojeve: lope, dele dhe dhie.
46. Sasia e konsumit të qumështit të freskët në fermë, si dhe produktet e qumështit në fermë.
47. Statistika mbi llogaritë ekonomike bujqësore me periodicitet tremujor.
48. Indeksi i çmimeve të produkteve bujqësore.
49. Çmimet absolute të llogaritura.
50. Çmimet e bujqësisë – tokës, përfshirë qiranë.

51. Të dhëna teknike dhe social - ekonomike të mbledhura për përmirësimin e statistikave të peshkimit sipas rekomandimeve të Eurostat bazuar në Manualet e FAO-s.
52. Sasia e pesticideve të përdorura sipas grup - kulturave.

### **Aktivitete statistikore të perealizuara**

Për këtë fushë prioritare nuk ka aktivitete statistikore të perealizuara.

## **Fusha prioritare 11: Statistikat Shumëqëllimore dhe Efiçenca e Fituar në Prodhim**

Kjo fushë prioritare mbulon koordinimin për konfidencialitetin statistikor dhe aksesin në mikrodata dhe gjithahshu standardizimin statistikor të të dhënave dhe metadatave duke përfshirë klasifikimet, cilësinë statistikore, regjistrat statistikorë të njësive ekonomike dhe përdorimin e standardit GSBPM në zbatimin e aktiviteteve statistikore.

- Objektivi i kësaj fushe prioritare është përafrimi i kuadrit ligjor për përcaktimin e kufijve për mbrojtjen e të dhënave konfidenciale sipas standardeve të kërkuara evropiane për mbrojtjen e të dhënave konfidenciale, metodologjinë për sigurimin e konfidencialitetit statistikor dhe zhvillimi i mjeteve për mbrojtjen e të dhënave mikro apo tabulare.

Agjencitë statistikore përgjegjëse: INSTAT.

### **Aktivitete statistikore të realizuara**

1. Koordinimi për konfidencialitetin statistikor dhe aksesin në mikrodata
2. Standardizimi statistikor i të dhënave dhe metadatave
3. Aplikimi i Generic Statistical Business Process Model (GSBPM)
4. Cilësia Statistikore
5. Mbrojtja e të dhënave

### **Rezultatet e pritshme**

1. Përmirësimi i proceseve të sigurimit të konfidencialitetit statistikor dhe dokumentimi i plotë i procedurave.
2. Aksesimi i sigurtë nga ana e përdoruesve të jashtëm i të dhënave statistikore nëpërmjet teknologjisë në nivel hardware dhe software, duke ruajtur ndërkohë konfidencialitetin.
3. Implementimi i standartit ESMS për metadatat strukturore në INSTAT.

4. Trasferimi në Eurostat i metadatës në përputhje me standartin evropian për të gjitha fushat e prodhimit statistikor.
5. Publikimi në faqen e web-it të INSTAT i raporteve të metadata-ve sipas fushave të prodhimit statistikor.
6. Rritja e ndërgjëgjësimit mbi rëndësinë e sistemit të metadatave në autoritete e tjera kombëtare që prodhojnë statistika zyrtare.
7. Ndjekja dhe identifikimi i problematikave të proceseve të prodhimit statistikor sipas modelit GSBPM.

### **Aktivitete statistikore të perealizuara**

Për këtë fushë prioritare nuk ka aktivitete statistikore të perealizuara.